



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-04/IA001

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 58, 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur për apelin e ndërmjetëm të z. Pjetër Shala të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me paraburgimin e tij (“Apeli”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 15 mars 2021, z. Shala u arrestua në Belgjikë në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 12 qershor 2020² dhe më 15 prill 2021³ u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë, Holandë.
2. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e z. Shala për lirim të përkohshëm (“Vendimi i Kontestuar”).⁴
3. Më 28 qershor 2021, z. Shala e apeloj vendimin e kontestuar.⁵

II. KLASIFIKIMI

4. Apeli është klasifikuar si konfidencial dhe rrjedhimisht ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të

¹ IA001/F00001, Apel i Mbrojtjes i “Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm”, 28 qershor 2021 (konfidencial).

² Shih F00008/A01, Fletarrestim për z. Pjetër Shala, 12 qershor 2020.

³ Shih F00019, Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me kusht të Mbrojtësit, 15 prill 2021.

⁴ F00045/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm, 15 qershor 2021.

⁵ Shih në përgjithësi Apelin.

riklasifikohet në kohën e duhur.

III. CAKTIMI

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Kai Ambos

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për Apelin.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 30 qershor 2021
Në Hagë,
Holandë